



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 180 Prot.
2

Koplik, më 17.02.2026

V E N D I M



Nr. 2 Datë 11 / 02 / 2026

**“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN
ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NE 6% TË FONDIT TË
NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 11.02.2026 duke u mbështetur në VKM 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e Kriteve, dokumentacionit dhe masës së Ndihmës Ekonomike”, si dhe Udhëzimit Nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” Sektorit i Sherbimeve Sociale:

V E N D O S I :

Të miratohen kriteret specifike mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Keshillit Bashkiak për të trajtuar me Ndihmë Ekonomike duke përdorur deri ne 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”familjet të cilat nuk shpallen fituese sipas formulës së pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e poshtëshënuara:

1. Familjet që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, konstatuar me vizitë familje nga grupi i punës.
2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me probleme shëndetësore dhe si të tillë janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk trajtohen me pagesë paafësie.
3. Familjet me kryefamiljare gra (nëna-vajza, të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
4. Personat që nuk kanë në pronësi një banesë, apo jetojnë me qira.
5. Individët me statusin e jetimit (të fituar) që nga momenti i daljes nga institucionet e përkujdesjes.
6. Familje ku kryefamiljarët janë pensionistë dhe kanë fëmijë nën 18 vjeç.
7. Familje të varfra të verifikuara me vizitë në familje që kanë në pronësi automjet dhe e verifikojnë me dokumentat përkatëse që nuk e kanë në përdorim.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 11.02.2026

Vota Pro 21

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 12.02.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
SEKTORI I SHERBIMEVE SOCIALE

Nr. 180/1 Prot.

Koplik, më 21.01.2016

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ Datë ___ / ___ /2026


**“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN
ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NE 6% TË FONDIT TË
NDIHMËS EKONOMIKE”**

Duke u mbështetur në VKM 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e Krieteve, dokumentacionit dhe masës së Ndihmës Ekonomike”, si dhe Udhëzimit Nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” Sektorit i Sherbimeve Sociale:

PROPOZOJ:

Të miratohen kriteret specifike mbi të cilat do të bazohet Vendimi i Keshillit Bashkiak për të trajtuar me Ndihmë Ekonomike duke përdorur deri ne 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”familjet të cilat nuk shpallen fituese sipas formulës së pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e poshtëshënuara:

1. Familjet që jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, konstatuar me vizitë familje nga grupi i punës.
2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me probleme shëndetësore dhe si të tillë janë të paafte për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk trajtohen me pagesë paaftesie.
3. Familjet me kryefamiljare gra (nëna-vajza, të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
4. Personat që nuk kanë në pronësi një banesë, apo jetojnë me qira.
5. Individët me statusin e jetimit (të fituar) që nga momenti i daljes nga institucionet e përkujdesjes.
6. Familje ku kryefamiljarët janë pensionistë dhe kanë fëmijë nën 18 vjeç.
7. Familje të varfra të verifikuara me vizitë në familje që kanë në pronësi automjet dhe e verifikojnë me dokumentat përkatëse që nuk e kanë në përdorim.



KRYETAR
TONIN MARINAJ